

AVANCIMI I PAVARËSISË FINANCIARE DHE LLOGARIDHËNIES NË UPZ

Mars 2016

I. TË DHËNA TË PËRGJTHSHME

(BAZA JURIDIKE E VEPRIMIT TË UPZ)

Universiteti Publik i Prizrenit është themeluar në bazë të **Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/87, datë 09 tetor 2009.**

Sipas pikës 2. të atij Vendimi, është paraparë që MASHT ta emërojë **Këshillin drejtues** i cili do të kujdesej për zbatimin e vendimit të mësipërm. Sipas pikës 3. të po të njëjtit vendim, MASHT ishte ngarkuar që të bëjë **“të gjitha përgatitjet e nevojshme që UPZ të regjistrojë studentët e parë në vitin akademik 2010/2011”**.

Përsa i përket implementimit të pikës 2. të Vendimit, me **Vendimin e Ministrit të MASHT nr. 815/01-B të datës 01 mars 2010**, është emëruar u.d. Sekretari i përhershëm i UPZ.

Nga tetori i vitit 2010, me sa jemi të informuar, MASHT i ka emëruar edhe dy **Drejtor themelues të UPZ.**

Ekipi i mësipërm, bashkë me personelin e angazhuar me kontratë mbi vepër, i ka bërë të gjitha përgatitjet dhe procedurat lidhur me regjistrimin studentëve në vitin e parë akademik 2010-2011.

Në fillim të muajit **Tetor 2010** është paraqitur në punë **Rektori gjerman Ronald Mönch** së bashku me bashkëpunëtorin e tij, z. **Martin Plat.**

Duke qeverisur me UPZ-në në themelim në bazë të kompetencave të cilat atij ia ka dhënë **Statuti i përkohshëm i UPZ datë 04. gusht 2010**, Rektori: Me **07.09.2010** e ka shpallur konkursin për rekrutimin e personelit civil dhe është Rekrutuar, përveç të tjerëve edhe **Një Zyrtar për buxhet dhe financa**

Sipas konkursit të dytë, **12.01.2011**, janë pranuar:

- **Një Zyrtar certifikues;**
- **Një Zyrtar i prokurimit.**

Sipas konkursit të tretë (**20.09.2011**), pas largimit të Rektorit gjerman, përveç tjerëve, janë pranuar:

- **Një zyrtar për paga dhe shpenzime;**
- **Një Zyrtar i pasurisë dhe asetëve;**

Sipas Statutit të përmendur më sipër, UPZ ka funksionuar deri më **1 korrik 2011**, kur është aprovuar **Ndryshimi dhe plotësimi i Statutit të Përkohshëm të UPZ.**

Në bazë të Vendimit të Ministrit të MASHT, nr. 01B/0074, datë 06.05.2011, janë emëruar dy Prorektorë, njëri nga të cilët i angazhuar për Financa dhe infrastrukturë.

Me 30 Maj 2013 miratohet Statuti i Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, në bazë të të cilit punohet edhe sot.

Në fillim të vitit 2014 emërohet Prorektori për financa i UPZ, që e ka kryer atë funksion shumë shkurtë.

Në fillim të këtij viti është emëruar Prorektori për Financa dhe Infrastrukturë i UPZ, që është në këtë pozitë edhe aktualisht.

UPZ ka funksionuar dhe funksionon edhe më tej si nën-program i MASHT.

II. AVANCIMI I PAVARËSISË FINANCIARE TË UPZ

Të themelohet një institucion që mbartë në vete përgjegjësi kaq të mëdha sikur puna e një Universiteti për Stafin menaxhues dhe atë të punës është sikur përgjegjësia e prindërve që të lindin fëmijë: Kënaqësia e të ngjizurit është shumë e shkurtër dhe zgjat pak por përgjegjësia dhe munda për t'i maturuar (rritur) ata është shumë i madh dhe zgjatë shumë.

Baza juridike e aktiviteteve financiare të Universitetit është **LIGJI PËR MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË, LGJI I PROKURIMIT dhe STATUTI I UPZ.**

Natyrisht, pavarësia financiare e UPZ është avancuar gradualisht.

a) MENAXHIMI I PAGAVE TË PERSONELIT

Menjëherë në fillim (2010) UPZ i është lejuar pavarësia për menaxhimin e pagave të personelit akademik dhe civil të UPZ.

Në kuadër të shërbimit për buxhet dhe financa janë përpiluar kontratat e punës së stafit akademik (sepse stafi civil ka kontrata afatgjate) si dhe janë mbajtur të gjitha relacionet me MAP, Shërbimin e pagave.

Problemi kyç me të cilin është ballafaquar shërbimi në këtë kohë ka qenë mënyra e përlogaritjes së pagave të stafit akademik, që është problem që na përcjell edhe tani.

Shënim:

Ju jeni të njoftuar se Ligji për buxhetin Buxheti i aprovuar për akëcilin vit paraqet “limit” buxhetor për atë vit.

Njëkohësisht, i limituar është edhe numri i punëtorëve për atë vit.

Nëse ky numër është p.sh. 130, nuk është e shkruar askund se këta bëjnë 130×40^h të shërbimit civil, që bëjnë $(130 \times 40^h \times 12 \text{ muaj}) = 62,400$ orë pune të cilat duhet paguar.

Pra, nuk është thjeshtë NJË I PUNËSUAR = NJË PUNËTORË, sepse një i punësuar mund të jetë me gjysmë orari (siç është rreth 70% e stafit akademik).

b) MENAXHMI I BUXHETIT PË MALLRA DHE SHËRBIME

Në fillim, në mungesë të Zyrtarit të certifikuar për prokurim, të gjitha furnizimet janë kryer duke u mbështetur në kontratat e MASHT, gjë që mund të bëhej, si nënprogram i tyre që jemi.

Pavarësia e dytë që është lejuar nga aspekti financiar është PROKURIMI. Pas punësimit të Zyrtarit për prokurim të gjitha procedurat janë kryer në UPZ, natyrisht në harmoni me Ligjin gjegjës të prokurimit (Procedurat e Kërkesave për prokurim; Shpalljes; Hapjeve; Vlerësimeve etj.) dhe procedurat për të gjitha pagesat dhe përgjegjësitë janë kryer në UPZ-përveç regjistrimeve në Free balance, për ç'gjë ne nuk kemi pasur të drejtë dhe ato janë kryer në MASHT (Zotimi i fondeve; Shpenzimi dhe Certifikimi dhe regjistrimi I pasurisë).

Gjithashtu në UPZ janë kryer të gjitha procedurat e pagesave nga kategoria ekonomike e Shpenzimeve komunale, Subvencioneve dhe transfereve).

Në UPZ janë kryer të gjitha procedurat lidhur me Tenderimin dhe pagesat e fondeve nga kategoria e Kapitaleve.

Sfidë të posaçme gjatë kësaj periudhe ka paraqitur bashkëpunimi me shërbimet gjegjëse të MASHT, të cilët kanë qenë të ngarkuar edhe me punë për Universitetet në themelim, dhe që ka paraqitur “barrë shtesë” për stafin e MASHT.

Gjatë tërë kësaj periudhe i janë bërë Raportime të rregullta tremujore Bordit të Përkohshëm Qeverisës të UPZ e pastaj Këshillit drejtues të UPZ si dhe ju kemi nënshtruar auditimeve të rregullta një herë ose dy herë në vit.

c) GJENDJA AKTUALE

Me **Ligjin për menaxhimin e financave publike....** është precizuar se Zyrtarët financiar të O.B., përgjegjës për afarizmin financiar të O.B. janë:

- a) Zyrtari Kryesor Administrativ;
- b) Auditori i brendshëm;
- c) Zyrtari kryesor financiar;
- d) Zyrtari i prokurimit, dhe
- e) Zyrtari certifikues.

Në fund të viti 2015 janë kryer edhe disa parapërgatitje teknike lidhur me pavarësimin financiar të UPZ (është krijuar lidhja për çasje në FREE-Balance).

Në fillim të këtij viti janë krijuar edhe dy lidhje për çasje në Free-balance dhe janë certifikuar për punë në këtë aspekt:

- 1) Zyrtari certifikues;
- 2) Zyrtari shpenzues;
- 3) Zyrtari i pranimit të mallit;
- 4) Zyrtari i të hyrave;
- 5) Zyrtari i pasurisë dhe asetëve, dhe
- 6) Zyrtari raportues.

Gjithashtu, sipas Statutit të UPZ, Këshilli Drejtues i tij, që është “autoriteti kryesor qeverisës i Universitetit”, “është përgjegjës për të gjitha vendimet në lidhje me çështjet financiare (buxheti, personeli, infrastruktura)...”.

Për kryerjen e plotë të punëve që kanë të bëjnë me financat nuk është certifikuar ende vetëm **Zyrtari zotues**, për shkak të organizimit të grupeve për trajnim që i bën MEF.

Ajo që ka mbetur e përbashkët me MASHT është përgatitja dhe negocimi i Kërkesave buxhetore (që e bënë MASHT edhe për UPZ) dhe që është një çështje që duhet zgjidhur sa më shpejtë që është e mundur.

Shënim:

Në UPZ është i punësuar Auditori i brendshëm, i cili nuk e kryen funksionin e tij në UPZ për arsye që ne nuk i dimë.

Shënim:

Për vitin buxhetor 2016 UPZ nuk e ka nënshkruar (s'e ka pranuar) buxhetin e aprovuar, që e bënë një Komision i formuar në MASHT, në të cilin UPZ nuk ka pasë asnjë përfaqësues.

Natyrisht, për të gjitha këto çështje që u përmendën me sipër (edhe të tjera që nuk munda t'i përmbledh në këtë prezantim të shkurtër) është diskutuar nëpër workshop-et e organizuara nga ky projekt (FAITH), që kanë ndihmuar shumë që të mund të konstatojmë se UPZ është plotësisht i përgatitur nga aspekti i kuadrove që ta kryej funksionin e tij financiar në mënyrë të pavarur.

Ju faleminderit për vëmëndjen tuaj